



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Qeveria – Vlada – Government Of Kosovo**  
**Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister**

**Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë**  
**Institut za Zlocine Pocijnene Tokom Rata na Kosovu**  
**Institute of Crimes Committed During the War in Kosovo**



**INSTITUTI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË  
KOSOVË (IKKL)**

**RAPORT I PUNËS**

**(8 nëntor 2025 – 8 maj 2026)**

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës raportuese 8 nëntor 2025 – 8 maj 2026, Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) ka shënuar progres të rëndësishëm në konsolidimin institucional, avancimin e dokumentimit shtetëror të krimeve të luftës dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe kujtesës historike. Instituti ka vazhduar zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe organizative, duke avancuar rolin e tij si mekanizëm qendror shtetëror për mbledhjen, verifikimin, përpunimin dhe ruajtjen e dokumentacionit që lidhet me krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.

Në funksion të avancimit të kornizës ligjore dhe funksionale të Institutit, gjatë periudhës raportuese është përmbyllur procesi i vlerësimit Ex-post të Ligjit Nr. 08/L-177, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, ndërsa raporti përkatës është proceduar për shqyrtim dhe miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ky proces përfaqëson hap të rëndësishëm drejt forcimit të bazës ligjore dhe institucionalizimit të mëtejshëm të mandatit të IKKL-së.

Në fushën e dokumentimit dhe arkivimit, Instituti ka vazhduar zgjerimin dhe konsolidimin e fondit arkivor dhe bibliotekar. Fondi arkivor ka arritur mbi 405 metra linearë material fizik dhe 21.75 TB materiale digjitale, ndërsa materialet janë siguruar nga gjithsej 1,067 burime të mbledhura në 13 shtete të ndryshme. Njëkohësisht, fondi bibliotekar i Institutit është zgjeruar në mbi 1,051 tituj librash dhe botimesh me rëndësi hulumtuese. Krahas zgjerimit të fondit, Instituti ka avancuar proceset e verifikimit, sistemimit dhe analizës së materialeve arkivore, duke kaluar gradualisht nga faza e grumbullimit fillestar drejt ndërtimit të një sistemi të standardizuar dhe të integruar të menaxhimit të materialeve.

Gjatë periudhës raportuese është shënuar progres i rëndësishëm edhe në zhvillimin e Databazës së Viktimave të luftës në Kosovë për periudhën 1998–2000. Prosesi është fokusuar në harmonizimin dhe verifikimin ndërburimor të të dhënave, përfshirë verifikimet shtesë në terren dhe integrimin e materialeve relevante arkivore dhe institucionale. Publikimi i databazës gjatë vitit 2026 pritet të shënojë moment me rëndësi të veçantë institucionale dhe shoqërore, duke krijuar për herë të parë një pasqyrë të plotë, të verifikuar dhe zyrtare mbi humbjet njerëzore të luftës në Kosovë.

Njëkohësisht, Instituti ka vazhduar zbatimin e projektit strategjik trevjeçar “Kujtesa e masakrave në Kosovë”, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Universitetin e Prishtinës, Muzeun Kombëtar dhe Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Projekti synon dokumentimin e kujtesës së të mbijetuarve të masakrave të luftës dhe krijimin e një baze të qëndrueshme hulumtuese dhe edukative për drejtësinë tranzicionale dhe kujtesën kolektive në Kosovë.

Në kuadër të fuqizimit të profilit akademik të Institutit, IKKL ka organizuar konferencën e dytë ndërkombëtare “From War to Recovery: A Multidisciplinary Approach Towards Kosovo’s War Trauma”, me pjesëmarrjen e mbi 200 studiuesve, ekspertëve dhe përfaqësuesve institucionalë vendorë dhe ndërkombëtarë. Po ashtu, Instituti ka zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve me universitete, institucione shkencore, organizata ndërkombëtare dhe partnerë institucionalë në Kosovë, rajon dhe më gjerë, duke forcuar dimensionin ndërkombëtar dhe ndërdisiplinor të veprimtarisë së tij.

Në fushën e kujtesës historike dhe komunikimit publik, IKKL ka vijuar organizimin e forumeve, ekspozitave dhe publikimeve në kuadër të platformës “Za n’Kujtesë”, si dhe ka zgjeruar praninë institucionale në media dhe rrjete sociale, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe promovimin e dokumentimit të krimeve të luftës në Kosovë.

Në aspektin financiar, Instituti ka realizuar nivel të lartë të ekzekutimit buxhetor për vitin fiskal 2025, me realizim prej 98.91%, duke reflektuar menaxhim efikas, transparent dhe të përgjegjshëm të resurseve

publike. Megjithatë, mbetet prioritarë sigurimi i mbështetjes financiare dhe infrastrukturore për realizimin e projektit të digjitalizimit të arkivit, zgjerimin e kapaciteteve hapësinore dhe fuqizimin e mbështetjes logjistike për aktivitetet në terren.

Pavarësisht sfidave operative dhe financiare, gjatë kësaj periudhe IKKL ka kaluar gradualisht nga faza e konsolidimit fillestar institucional drejt zhvillimit funksional dhe afirmimit më të gjerë profesional dhe ndërkombëtar, duke forcuar rolin si institucion qendror shtetëror për dokumentimin e krimeve të luftës, ruajtjen e kujtesës historike dhe avancimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale në Republikën e Kosovës.

IKKL NË SHIFRA – PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE KRYESORE (8 NËNTOR 2025 – 8 MAJ 2026)

**1 PASURIMI I KORNIZËS LIGJORE**

- Draft-Raporti Ex-post i Ligjit Nr. 08/L-177 proceduar në Qeveri
- Harmonizimi i ligjit me legjislacionin në fuqi
- Saktësimi i kompetencave dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional
- Udhëzimi Administrativ në fuqi (shtator 2025)
- Rekomandime për ndryshime dhe plotësime ligjore

**2 BURIMET NJERËZORE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL**

**36**

pozita aktive

**10**

pozita në proces rekrutimi

**10**

trajnime profesionale

Sipas Rregullores: 74 pozita të planifikuara (2026)

46 / 74 pozita të mbuluara

62%

**3 DOKUMENTIMI & ARKIVI**

<b>405.26 m</b>	Materiale fizike (metra linearë)
<b>21.75 TB</b>	Materiale digjitale (të ruajtura)
<b>1,051</b>	Tituj librash në bibliotekën institucionale
<b>417</b>	burime të reja arkivore
<b>13</b>	shtete burimore
<b>282</b>	procesverbale dorëzimi të nënshkruara


**4 VERIFIKIMI & ANALIZA**

**466** regjistratorë të verifikuar

**24** fonde arkivore të mbuluara

**3,395** fotografi të evidentuara

Struktura e temave të analizuara



Kalim nga verifikimi bazë drejt analizës së avancuar dhe databazave të strukturuar.

**5 DATABAZA E VIKTIMAVE**

- Fazë finale e Databazës së Viktimave të Luftës (1998–2000)
- 42 raste masakrash të verifikuara
- 21 lokacione të "turizmit të errët"
- Verifikim ndërburimor dhe ndërinstitucional
- Platformë digjitale funksionale

Publikimi planifikohet gjatë vitit 2026.

**6 KONFERENCA NDËRKOMBËTARE "FROM WAR TO RECOVERY"**

**200+**

pjesëmarrës vendorë dhe ndërkombëtarë

**8** panele diskutimi

**4** sesione shkencore

**2** movie nights

Pjesëmarrës nga universitete dhe institucione nga Mbretëria e Bashkuar, Australia, Afrika e Jugut, Suedia, Kosova, Shqipëria dhe të tjera.

**7 PROJEKTI STRATEGJIK "KUJTESA E MASAKRAVE NË KOSOVË"**

**45+** intervista të realizuara

**2.4 TB** materiale audio-vizuale të mbledhura

**10** masakra kryesore të dokumentuara

Partnerë institucionale Universiteti i Prishtinës

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Muzeu i Kosovës

Biblioteka Kombëtare e Kosovës

Platforma kulturore dhe shkencore "Za n'Kujtesë" është lansuar.

**8 BASHKËPUNIMET INSTITUCIONALE**

**15**

marrëveshje të reja gjatë periudhës raportuese

TOTALI I MARRËVESHJEVE

**32**

(nga themelimi)

Bashkëpunim me:

Universitete | ASHAK | ARC | Institucione ndërkombëtare | Institucione vendore

**9 PRANIA PUBLIKE & KOMUNIKIMI**

**898K**

shikime videosh në Facebook

**22K**

ndërveprime në rrjetet sociale

**944**

klikime në linke

**6,800+**

ndjekës në Facebook



Rritje e ndjeshme e vizibilitetit dhe angazhimit publik.

**10 RAPORTI FINANCIAR**

**98.91%**

Realizimi i buxhetit 2025

**99.77%**

Realizimi i kategorisë Mallra & Shërbime

**726,000 €**

Buxheti i planifikuar për vitin 2026

**42.67%**

Ekzekutimi aktual i buxhetit 2026

Menaxhim i qëndrueshëm financiar dhe shfrytëzim efikas i burimeve.

**11 SFIDAT KRYESORE OPERATIVE**

Vonesa në digjitalizimin e arkivit

Mungesa e hapësirave adekuate

Kufizime buxhetore dhe mungesë e investimeve

Kapacitete të pamjaftueshme të stafit

Mungesë e mjeteve të transportit për zyrat rajonale

Këto sfida kërkojnë adresim të vazhdueshëm institucional për të garantuar realizimin e mandatit.

**12 PRIORITETET KRYESORE PËR 2026**

- 1 Publikimi i Databazës së Viktimave të Luftës
- 2 Fillimi i procesit të digjitalizimit të arkivit
- 3 Zgjerimi i infrastrukturës fizike dhe arkivore
- 4 Rritja e kapaciteteve profesionale dhe teknologjike
- 5 Forcimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare

“Kalimi nga konsolidimi drejt afirmimit ndërkombëtar të IKKL-së.”

PËRMBAJTJA

Pasurimi i Kornizës Ligjore .....	1
Zhvillimi i infrastrukturës fizike dhe burimeve njerëzore .....	2
Infrastruktura dhe logjistika .....	2
Stafi dhe burimet njerëzore .....	2
Trajnimi dhe zhvillimi profesional.....	3
<b>Dokumentimi dhe Hulumtimi</b> .....	3
Dokumentimi.....	3
Mbledhja e materialeve dhe dëshmive.....	3
Verifikimi dhe analizimi i materialeve arkivore .....	5
Përpunimi, Arkivimi dhe Biblioteka .....	6
Hulumtimi .....	6
Konferenca e Dytë Ndërkombëtare “From War to Recovery: A Multidisciplinary Approach to Kosovo’s War Trauma” (17-20 shkurt 2026).....	6
Shënim mbi Analizat e Specializuara (DAS) .....	7
Projekti Strategjik trevjeçar (2025-2028): “Kujtesa e masakrave në Kosovë: Dokumentimi i kujtesës së të mbijetuarve të 10 masakrave të kryera në Kosovë gjatë periudhës së luftës 1998-1999 .....	7
Kolana “Za n’Kujtesë” – Forume, Ekspozita dhe Publikime .....	8
Ekspozitat në vend dhe në diasporë & arritje të tjera.....	8
Veprimet bashkëpunuese dhe marrëveshjet ndërinstitucionale .....	9
Pjesëmarrja në forume dhe seminare ndërkombëtare .....	11
Prania mediatike dhe sensibilizimi publik.....	12
Raporti financiar .....	13
Sfidat operative .....	14
Prioritetet strategjike për periudhën pasuese (2026).....	15
Kërkesat kryesore për periudhën pasuese.....	16
Nevoja për rritje të buxhetit – Projekti i Digjitalizimit .....	16
Nevoja për zgjerim hapësinor .....	16
Nevoja për përmirësim të logjistikës dhe transportit.....	16

**LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE**

<b>Tabela 1.</b> Shpërndarja e pozitave dhe plani i rekrutimit sipas kategorive për vitin 2025-2026 .....	3
<b>Tabela 2.</b> Krahasimi i burimeve të materialeve arkivore të dorëzuara në IKKL .....	5
<b>Tabela 3.</b> Krahasimi i burimeve të materialeve arkivore të dorëzuara në IKKL sipas periudhave raportuese	7
<b>Tabela 4.</b> Krahasimi i vëllimit të materialeve arkivore të dorëzuara në IKKL sipas periudhave raportuese ...	8
<b>Tabela 5.</b> Strukturimi i konferencës .....	9
<b>Tabela 6.</b> Bashkëpunimet institucionale sipas periudhave raportuese .....	14
<b>Tabela 7.</b> Numri i ndjekësve në rrjetet sociale të IKKL-së (Facebook, Instagram dhe LinkedIn) në dy periudhat raportuese.....	15

## PASURIMI I KORNIZËS LIGJORE

Në aspektin e zhvillimit ligjor dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë së zbatimit të ligjit, Instituti ka propozuar vlerësimin Ex-post të Ligjit Nr. 08/L-177, si mjet për rregullim më të mirë juridik. Pas shqyrtimit nga Këshilli i Drejtorëve të Departamenteve Ligjore të Ministrive, Draft-Raporti për Vlerësimin Ex-post të Ligjit Nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë është proceduar për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Raporti përmban analiza dhe rekomandime konkrete për adresimin e sfidave dhe boshllëqeve të identifikuara gjatë zbatimit të Ligjit Nr. 08/L-177, duke përfshirë nevojën për harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi, saktësimin e kompetencave të Institutit, si dhe forcimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional. Rekomandimet përfshijnë gjithashtu propozime për ndryshime dhe plotësime në ligje dhe akte të tjera nënligjore, me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të mandatit dhe funksionimit të Institutit. Procesi i vlerësimit është zhvilluar nën koordinimin e Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht Zyrës Ligjore, në bashkëpunim të ngushtë me IKKL-në, duke reflektuar angazhimin institucional për avancimin e bazës ligjore dhe funksionale të Institutit në përputhje me standardet e administrimit publik dhe nevojat praktike të dokumentimit dhe hulumtimit të krimeve të luftës në Kosovë. Nga aspekti normativ, Ligji për Institutin ka paraparë nxjerrjen e dy akteve nënligjore. Gjatë periudhës raportuese janë përmbushur obligimet që rrjedhin nga ky ligj, ndërsa akti përkatës nënligjor – Udhëzimi Administrativ (IKKL) Nr. 01/2025 për Procedurat dhe Masat për Shfrytëzimin e Materialeve të Arkivit, Sigurinë e të Dhënave Personale apo të Dhënave të tjera të Ndjeshme në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë – ka hyrë në fuqi në shtator 2025.

## ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

### INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA

Gjatë periudhës raportuese nëntor 2025 – maj 2026, nuk janë shënuar zhvillime të theksuara në aspektin e zgjerimit të mëtejshëm të infrastrukturës institucionale. Megjithatë, IKKL ka vazhduar funksionimin në kuadër të kapaciteteve ekzistuese, duke ruajtur nivelin operacional të zyrave qendrore dhe rajonale të themeluara në periudhën paraprake. Gjatë kësaj periudhe, çështje kyçe kanë qenë diskutimet lidhur me procesin e zhvendosjes së Agjencisë Kadastrale të Kosovës, i cili lidhet drejtpërdrejt me lirimin e hapësirave të destinuara për IKKL-në. Përkundër diskutimeve në këtë drejtim, Instituti mbetet ende në pritje të përfundimit të këtij procesi, me qëllim të vendosjes në hapësirat e reja të parapara. Në mungesë të këtyre hapësirave, aktivitetet institucionale janë zhvilluar në kushte që kanë kërkuar menaxhim më efikas të burimeve logjistike të përdorimit të hapësirave aktuale. Kjo situatë ka ndikuar në kufizimin e mundësive për zgjerim të mëtejshëm të kapaciteteve organizative.

### STAFI DHE BURIMET NJERËZORE

Fillimisht duhet të potencohet se përgjatë vitit 2025, një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve (gjithsej 9 prej tyre) e kanë lënë punën në IKKL, me arsytime të ndryshme përfshirë ngarkesën e madhe emocionale, dëshirën për t'u transferuar në institucione tjera për shkak të kushteve më të mira të punës, etj. Megjithatë, IKKL ka ndërmarrë hapa drejt zëvendësimit të tyre si dhe fuqizimit të burimeve njerëzore, në përputhje me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm (ZKM Nr. 04/2024). Qëllimi kryesor mbetet ndërtimi i një ekipi të aftë për të realizuar me efikasitet objektivat e mandatit institucional. Aktualisht, Instituti operon me 36 pozita të plotësuara, dhjetë pozita në proces rekrutimi dhe tetëmbëdhjetë (18) të planifikuara për vitet në vijim, për shkak të mungesës së buxhetit për të proceduar tutje në këtë drejtim përgjatë vitit 2026. (Tabela 1).

*Tabela 1. Shpërndarja e pozitave dhe plani i rekrutimit sipas kategorive për vitin 2025-2026*

Nr.	Kategoria	Pozitat aktuale	Në proces të rekrutimit	Rekrutimi në pritje	Planifikimi i zyrtarëve sipas Rregullores (2026) (Kapitulli 1.1)
1	Drejtues i lartë	1			
2	Drejtues i mesëm	1	2		
3	Drejtues i ulët	7	3		
4	Profesional 1	23	1		23
5	Profesional 2	4	4		5
6	Ekspertë të jashtëm	/			
7	Ekspertë të diplomacisë qytetare	/			
TOTALI		36	10		28

## TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Gjatë këtyre gjashtë muajve të fundit, të gjithë zyrtarët e Institutit kanë ndjekur 10 trajnime të ndryshme profesionale, të cilat janë afruar për stafin me qëllim të ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe avancimit të kompetencave profesionale në fushat kyçe të administratës publike, legjislacionit, menaxhimit të projekteve dhe drejtësisë tranzicionale. Trajnimet janë realizuar kryesisht në bashkëpunim me Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Museum Reporting House, duke mbuluar tema të rëndësishme për funksionimin dhe zhvillimin institucional të IKKL-së. Në kuadër të këtyre programeve, zyrtarët kanë ndjekur trajnime edhe në fusha si hartimi dhe vlerësimi Ex-post i legjislacionit, teoria e përgjithshme e akteve juridike, menaxhimi i financave publike, komunikimi strategjik në sektorin publik, analiza statistikore dhe interpretimi i të dhënave (SPSS), politikat dhe legjislacioni në administratën publike, si dhe përdorimi i mjeteve për menaxhim të projekteve. Një pjesë e konsiderueshme e stafit ka marrë pjesë edhe në trajnimin për drejtësinë tranzicionale, krimet e luftës dhe raportimin e përgjegjshëm mediatik, duke reflektuar fokusin institucional në avancimin e njohurive profesionale në fushat që lidhen drejtpërdrejt me mandatin e Institutit. Këto trajnime kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale dhe analitike të stafit, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së punës, efikasitetit institucional dhe përmbushjes më të avancuar të objektivave dhe detyrave të Institutit.

### Dokumentimi dhe Hulumtimi

#### DOKUMENTIMI

##### MBLEDHJA E MATERIALEVE DHE DËSHMIVE

Gjatë periudhës raportuese, IKKL ka vijuar zgjerimin e fondit arkivor, duke konsoliduar njëkohësisht rrjetin e burimeve dhe duke rritur diversitetin e materialeve të mbledhura. Krahasuar me periudhat paraprahe, ky zhvillim reflekton një kalim nga zgjerimi intensiv drejt një qasjeje më të strukturuar dhe selektive në mbledhjen e materialeve me vlerë dokumentuese.

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore janë regjistruar 417 burime të reja, krahasuar me 582 burime përgjatë periudhës një vjeçare 2024–2025 dhe me vetëm 67 burime në periudhën 2023–2024. Rritjet e vazhdueshme në raport me periudhat paraprahe, shoqërohen gjithashtu edhe me përmirësime në cilësinë dhe targetimin e burimeve të mbledhura. Koleksionuesit privatë mbeten burimi kryesor (282), ndërsa vihet re rritje edhe e kontributeve nga institucionet fetare, mediat e veçanërisht burimet online, duke reflektuar kështu diversifikim më të madh të burimeve dhe adaptim të vazhdueshëm ndaj formave bashkëkohore të dokumentimit (*Tabela 2*). Shtrirja ndërkombëtare mbetet e konsoliduar, me materiale të siguruara nga 13 shtete, përfshirë Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Gjermaninë, Zvicrën, Italinë, Mbretërinë e Bashkuar, SHBA-në, Kanadanë, Suedinë, Norvegjinë dhe Austrinë. Kjo shtrirje forcon dimensionin ndërkufitar të arkivit dhe bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë. Në aspektin procedural, gjatë periudhës raportuese, nënshkrimi i mbi 282 procesverbaleve të dorëzimit vetëm nga koleksionuesit privat dëshmon standardizim të proceseve dhe rritje të transparencës në pranimin e materialeve (*Tabela 2*). Në kuadër të aktiviteteve për mbledhjen dhe pasurimin e fondit dokumentar, gjatë periudhës raportuese IKKL ka pranuar materiale arkivore të digitalizuara nga UNDP, e cila në bashkëpunim me Ambasadën Britanike në Kosovë, kanë kontribuar në digjitalizimin e fondit të z. Ahmet Grajqevcit. Iniciativa të tilla përfaqësojnë mekanizëm të rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme të fondit arkivor, duke mundësuar përfshirjen e burimeve të reja dhe të standardizuara në sistemin dokumentues të Institutit.

Tabela 2. Krahasimi i burimeve të materialeve arkivore të dorëzuara në IKKL sipas periudhave raportuese

	Periudha nëntor 2023 – nëntor 2024	Periudha nëntor 2024 – nëntor 2025	Periudha 8 nëntor 2025 – 8 maj 2026	TOTAL
<i>Koleksionues privatë</i>	26	489	282	797
<i>Komuna</i>	24	9	4	37
<i>Organizata joqeveritare</i>	9	6	7	22
<i>Institute shkencore</i>	2	5	6	13
<i>Ministri</i>	3	3	0	6
<i>Institucione arkivore</i>	2	4	1	7
<i>Institucione bibliotekare</i>	1	2	2	5
<i>Ambasada</i>	0	1	0	1
<i>Media</i>	0	6	7	13
<i>Institucionet fetare</i>	0	4	10	14
<i>Burime online</i>	0	54	98	152
<i>Totali</i>	67	583	417	1067
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>				<b>1067</b>

Sa i përket vëllimit, fondi arkivor ka arritur në 405.26 metra linearë materiale fizike dhe 21.75 TB të dhëna digjitale, ndërsa fondi bibliotekar është zgjeruar në 1,051 tituj, duke mbështetur më tej kapacitetet kërkimore dhe dokumentuese të Institutit. Krahasuar me periudhën paraprake raportuese, vërehet një ulje relative e volumit të materialeve të reja të pranuar gjatë kësaj periudhe (4.75 m dhe 1.15 TB), e cila ndërlidhet edhe me faktin se periudha aktuale raportuese përfshin vetëm gjashtë muaj, për dallim nga periudha paraprake njëvjeçare. Njëkohësisht, kjo reflekton edhe orientimin më të madh institucional drejt përpunimit, sistemimit dhe verifikimit të materialeve ekzistuese arkivore. (Tabela 3).

Tabela 3. Krahasimi i vëllimit të materialeve arkivore të dorëzuara në IKKL sipas periudhave raportuese

Lloji i materialit	nëntor 2023 - nëntor 2024	nëntor 2024 - nëntor 2025	nëntor 2025 - maj 2026	TOTALI I PËRGJITHSHËM
<i>Materiale fizike</i>	230.51 m	170 m	4.75 m	405.26 m
<i>Materiale digjitale</i>	14.64 TB	5.96 TB	1.15 TB	21.75 TB
<i>Tituj librash</i>	/	951	187	1051

Në tërësi, trendi ndërmjet periudhave tregon rritje të vazhdueshme nga faza e zgjerimit të shpejtë drejt konsolidimit dhe menaxhimit të avancuar të fondit arkivor. Ky zhvillim e pozicionon arkivin e IKKL-së si një

infrastrukturë të besueshme dhe gjithnjë e më relevante për dokumentimin e krimeve të luftës dhe ndërtimin e kujtesës historike.

## VERIFIKIMI DHE ANALIZIMI I MATERIALEVE ARKIVORE

Gjatë periudhës nëntor 2025 – maj 2026, Divizioni i Verifikimit ka hyrë në një fazë më të avancuar të konsolidimit, duke kaluar nga verifikimi fillestar në verifikimin e thelluar të materialeve arkivore. Ky tranzicion reflekton kalimin nga një qasje kryesisht regjistruese drejt një qasjeje analitike dhe përmbajtësore, duke rritur ndjeshëm cilësinë dhe përdorshmërinë e të dhënave.

Krahasuar me periudhën paraprake (nëntor 2024 – nëntor 2025), gjatë së cilës janë verifikuar në nivel bazë 1,266 regjistratorë që mbulojnë 23 fonde arkivore, në periudhën raportuese janë verifikuar edhe 466 regjistratorë shtesë. Ndërkohë, mbulimi i fondeve është rritur (nga 23 në 24, për këtë periudhë), duke reflektuar zgjerim të ndjeshëm të shtrirjes së procesit të verifikimit dhe përfshirje më të gjerë të materialeve arkivore në sistemin e Institutit. Në aspektin e përmbajtjes, përderisa në fazën fillestare fokusi ka qenë në identifikimin dhe kategorizimin bazë të materialeve, faza aktuale karakterizohet nga thellimi i analizës dhe strukturimi i të dhënave. Ndërtimi i bazës së qendërzuara të verifikimit ka mundësuar kalimin nga regjistrimi statik në menaxhim dinamik të informacionit, duke integruar elemente kyçe si: identifikimi i burimit, kategorizimi i dëmit, vlerësimi financiar dhe verifikimi ndërburimor. Të dhënat tregojnë gjithashtu një vazhdimësi në strukturën e materialeve të trajtuara, ku dëmet ekonomike përbëjnë rreth 26% të rasteve, ndërsa humbjet njerëzore rreth 74%. Ky raport tregon profil të materialeve arkivore të disponueshme dhe fokus të vazhdueshëm në dokumentimin e dëmeve materiale. Sa i përket dokumentimit vizual, pas evidentimit të 38,510 njësive në periudhën e parë, gjatë kësaj periudhe janë shtuar edhe rreth 3,395 fotografi të tjera, duke dëshmuar vazhdimësi në pasurimin e fondit dhe në sistemin e materialeve ekzistuese (Tabela 4).

*Tabela 4. Të dhëna kyçe të verifikimit*

Përshkrimi	Periudha nëntor 2024 – nëntor 2025	Periudha nëntor 2025 – maj 2026
<i>Regjistrator te verifikuar</i>	1,266	466
<i>Fonde të mbuluara</i>	23	24
<i>Fotografi te evidentuara</i>	38,510	3,395
<i>Dëme ekonomike</i>	95%	26%
<i>Humbje njerëzore</i>	5%	74%

Ne tërësi, krahasimi ndërmjet dy periudhave tregon kalim nga faza e grumbullimit dhe verifikimit bazë drejt një faze të avancuar analitike, të mbështetur në sisteme të standardizuara dhe databaza të strukturuar. Ky zhvillim përbën hap strategjik drejt ndërtimit të një sistemi të besueshëm, të qëndrueshëm dhe të krahasueshëm dokumentues, duke rritur potencialin e përdorimit të të dhënave për qëllime institucionale dhe hulumtime shkencore në të ardhmen.

## PËRPUNIMI, ARKIVIMI DHE BIBLIOTEKA

Gjatë periudhës raportuese, në përputhje me Ligjin nr. 08/L-177, IKKL ka vijuar zhvillimin dhe konsolidimin e funksionit të arkivimit dhe bibliotekës si komponentë kyçe të infrastrukturës dokumentuese të Institutit. Në fushën e arkivimit, është shënuar rritje e vazhdueshme e fondit arkivor fizik dhe digjital, duke reflektuar intensifikimin e aktiviteteve të mbledhjes dhe pranimit të materialeve. Si rezultat, hapësira ekzistuese e arkivit fizik është afër kapacitetit maksimal të saj, duke e bërë të domosdoshme zgjerimin e saj në afat të shkurtër për të garantuar ruajtjen e sigurt dhe të qëndrueshme të materialeve. Në këtë kontekst, materiali i grumbulluar deri më tani ka filluar të sistematizohet në kuti speciale arkivore, të cilat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për ruajtjen dhe konservimin afatgjatë të dokumenteve fizike. Ky proces përfaqëson hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kushteve të ruajtjes dhe mbrojtjes së materialeve nga dëmtimet fizike dhe faktorët mjedisorë. Paralelisht, janë ndërmarrë masa për rritjen e standardizimit në trajtimin dhe organizimin e materialeve arkivore, duke forcuar më tej kapacitetin e Institutit për menaxhim profesional të fondit dokumentar. Megjithatë, zgjerimi i hapësirës arkivore dhe investimi në infrastrukturë mbetet prioritet kritik për të përballuar fluksin në rritje të materialeve dhe për të siguruar përmbushjen e standardeve bashkëkohore arkivore.

Në fushën e bibliotekës, ka vijuar puna për formalizimin e Bibliotekës së IKKL-së, e cila për shkak të kufizimeve hapësinore mbetet ende në fazë përgatitore. Deri më tani janë regjistruar 1,051 tituj librash, të dhuruar nga individë, institucione dhe partnerë ndërkombëtarë, të pajisur me të dhëna të plota bibliografike dhe kode unike identifikimi. Gjithashtu, është në proces vendosja e vulës institucionale për garantimin e pronësisë dhe mirëmbajtjes së fondit bibliotekar. Formalizimi i plotë i bibliotekës, në kombinim me zhvillimin e mëtejshëm të arkivit, do të përmbyllë krijimin e një sistemi të integruar kërkimor dhe dokumentar, duke forcuar kapacitetet e IKKL-së në fushën e dokumentimit, ruajtjes së kujtesës historike dhe zhvillimit të hulumtimeve shkencore.

## HULUMTIMI

### KONFERENCA E DYTË NDËRKOMBËTARE “FROM WAR TO RECOVERY: A MULTIDISCIPLINARY APPROACH TO KOSOVO’S WAR TRAUMA” (17-20 SHKURT 2026)

Gjatë periudhës raportuese, IKKL organizoi konferencën e dytë ndërkombëtare “FROM WAR TO RECOVERY: A MULTIDISCIPLINARY APPROACH TOWARDS KOSOVO’S WAR TRAUMA”, e mbajtur më 17 – 20 shkurt 2026 në ambientet e Administratës Qendrore të Universitetit të Prishtinës. Konferenca ofroi analiza të thelluara mbi traumën e luftës dhe proceset e rimëkëmbjes, përmes një qasjeje të integruar dhe ndërdisiplinore. Punimet dhe diskutimet iu janë qasur krimeve të luftës nga perspektiva juridike, historike, sociologjike, psikologjike dhe politike, duke e vendosur përvojën dhe zërin e viktimave në qendër të debatit shkencor. Konferenca u hap nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, dhe mbledhi mbi 200 pjesëmarrës, përfshirë studiues vendorë e ndërkombëtarë, përfaqësues të institucioneve akademike, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve shtetërore (Tabela 5). Gjatë konferencës u përfshinë sesione prezantimi të punimeve shkencore, panele diskutimi, fjalime hapëse nga personalitete ndërkombëtare dhe dy mbrëmje filmike kushtuar kujtesës kolektive mbi luftën. Pas konferencës, planifikohet publikimi i vëllimit të dytë shkencor, nën redaktimin e Dr. Cathrine Althaus (University of New South Wales, Australi) dhe Dr. Blerina Këllezi (Nottingham Trent University, MB). IKKL do të ketë rol mbikëqyrës, ndërsa botimi final pritet të publikohet nga shtëpi botuese ndërkombëtare prestigjioze, duke e pozicionuar këtë nismë si një kontribut të rëndësishëm në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe kujtesës historike.

Tabela 5. Strukturimi i konferencës

Elementi	Përshkrimi
Titulli	From War to Recovery: A Multidisciplinary Approach Towards Kosovo's War Trauma
Data	17-20 shkurt 2026
Vendi	Ambientet e Administratës Qendrore të Universitetit të Prishtinës
Pjesëmarrës	Mbi 200 studiues, ekspertë dhe profesionistë
Panelet kryesore	8 panele diskutimi
Sesionet	4 sesione prezantimi të ndara sipas tematikave
Shfaqje filmi	2 movie nights – filma me tematikë nga lufta në Kosovë
Institucionet pjesëmarrëse	Nottingham Trent University, University of Stockholm, University of Pretoria, University of Birmingham, University of Tirana, University of Prishtina, Kosova Rehabilitation Center for Torture Victims, KRCT, Ministry of Culture, Youth and Sports of Republic of Kosovo, Center of Albanological Studies, University of Shkodra, Institute of Forensic Medicine, Government Commission on Missing Persons, Medica Kosova, UBT College, e të tjera.

## SHËNIM MBI ANALIZAT E SPECIALIZUARA (DAS)

Divizioni i Analizave të Specializuara (DAS) ka luajtur rol thelbësor në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave për gjitha viktimat e luftës gjatë vitit 2025. Gjatë kësaj periudhe, Divizioni ka shënuar përparim të ndjeshëm në ndërtimin dhe verifikimin e bazës së të dhënave për viktimat e luftës, duke përfshirë periudhën 1 janar 1998 – 20 qershor 1999, si dhe viktimat e pas luftës si pasojë e saj, për periudhën 21 qershor 1999 – 31 dhjetor 2000.

Kjo bazë e të dhënave përfshin informacione të verifikuara për viktimat e vrara, të zhdukur me dhunë dhe të vdekurit si pasojë e luftës, pa dallim etnie apo statusi civil. Për çdo rast janë konsultuar dhjetëra burime referuese, ndërsa në rastet e mospërputhjeve janë realizuar verifikime në terren për të siguruar saktësi maksimale. Gjithashtu, është krijuar një platformë digjitale e integruar, e cila mundëson regjistrimin, kërkimin dhe analizimin e të dhënave për viktimat, burimet dhe ngjarjet e luftës, duke vendosur kështu themelet për data bazë të qëndrueshme dhe funksionale. Publikimi i të dhënave për të vrarët, të vdekurit si pasojë e luftës dhe të pagjeturit planifikohet gjatë vitit 2026. Paralelisht, Divizioni ka kontribuar në verifikimin e 42 rasteve të masakrave të dokumentuara dhe në identifikimin e 21 pikave të turizmit të errët, secila e shoqëruar me narrativë dokumentare të bazuar në fondet arkivore dhe metodologjinë e IKKL-së.

## PROJEKTI STRATEGJIK TREVJEÇAR (2025-2028): “KUJTESA E MASAKRAVE NË KOSOVË: DOKUMENTIMI I KUJTESËS SË TË MBIJETUARVE TË 10 MASAKRAVE TË KRYERA NË KOSOVË GJATË PERIUdhËS SË LUFTËS 1998-1999

IKKL-ja ka vazhduar zbatimin e projektit trevjeçar “Kujtesa e Masakrave në Kosovë: Dokumentimi i kujtesës së të mbijetuarve të masakrave gjatë luftës 1998–1999”. Ky projekt përfaqëson vazhdimësi të punës paraprake të ndërmarrë në kuadër të dokumentimit të Masakrës së Krushës së Madhe, si dhe synon dokumentimin e dhjetë masakrave kryesore: Mejë, Studime, Sllovi, Reçak, Lybeniq, Qyshk, Poklek, Makoc, Suharekë dhe Krushë e Vogël. Në kuadër të projektit janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi ndërmjet IKKL-së, Institutit të Antropologjisë së Universitetit të Prishtinës (IAUP), Ministrisë së Kulturës,

Rinisë dhe Sportit (MKRS), Biblioteka Kombëtare 'Pjetër Bogdani', dhe Muzeu i Kosovës. Deri më tani janë zhvilluar mbi 50 intervista në teren. Gjatë zbatimit të projektit parashihet të realizohen rreth 1,000 intervista me dëshmitarë dhe të mbijetuar të dhjetë masakrave, me qëllim krijimin e një baze të çmuar narrative, vizuale dhe dokumentare, e cila do të kontribuojë në ruajtjen e kujtesës kolektive, si dhe në kërkimet shkencore, edukim dhe drejtësi tranzicionale.

---

## **KOLANA “ZA N’KUJTESË” – FORUME, EKSPOZITA DHE PUBLIKIME**

IKKL ka lansuar kolanën “Za n’Kujtesë”, si platformë kulturore dhe shkencore që ndërthur kërkimin akademik me përkujtimin publik, duke hapur diskutime mbi temat e heshtura të historisë së Kosovës përmes forumeve, ekspozitave dhe botimeve.

---

## **FORUMI & EKSPOZITA “HELMIMET E NXËNËSVE NËPËR SHKOLLA (1990–1992)”**

Në kuadër të aktiviteteve për promovimin e kujtesës kolektive dhe ndërgjegjësimit publik, gjatë periudhës raportuese IKKL, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ka organizuar forumin e dytë në kuadër të platformës “Za n’Kujtesë”, të dedikuar fenomenit të helmimeve masive të nxënësve në Kosovë gjatë viteve 1990–1992. Ky aktivitet trajtoi një nga episodet më të ndjeshme dhe më pak të dokumentuara të historisë së rezistencës paqësore në Kosovë. Forumi synoi të kontribuojë në ruajtjen e kujtesës historike, nderimin e viktimave dhe forcimin e diskursit mbi të vërtetën dhe drejtësinë, veçanërisht në kontekstin e sistemit arsimor dhe edukimit qytetar. Në kuadër të këtij aktiviteti është përgatitur dhe publikuar edhe katalogu, i cili përmbledh materiale arkivore dhe dëshmi të kohës, duke shërbyer si burim referimi për hulumtime të mëtejshme dhe për përdorim edukativ. Si pjesë përbërëse e forumit, është organizuar edhe ekspozita tematike me fotografi dhe materiale dokumentare, e cila ka qëndruar e hapur për pesë ditë radhazi në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Ekspozita ka shërbyer si hapësirë reflektimi dhe ndërgjegjësimi publik, duke ofruar qasje të drejtpërdrejtë në dëshmitë vizuale të një prej ngjarjeve më të rënda të viteve '90. Në tërësi, ky aktivitet ka përforcuar rolin e IKKL-së si institucion kyç në dokumentimin dhe promovimin e kujtesës historike, duke kontribuar në ndërtimin e një narrative të bazuar në fakte dhe në mbështetje të proceseve të drejtësisë tranzicionale.

---

## **EKSPOZITAT NË VEND DHE NË DIASPORË & ARRITJE TË TJERA**

Gjatë periudhës raportuese, IKKL ka prezantuar një sërë ekspozitash në Kosovë, rajon dhe në vende të tjera, duke përdorur materiale origjinale nga fondet e veta arkivore, përfshirë fotografi, dokumente, procesverbale dhe dëshmi audio-vizuale. Përmes këtyre aktiviteteve, Instituti ka kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e kujtesës historike, rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, si dhe në forcimin e bashkëpunimit me institucionet partnere dhe komunitetet e mërgatës shqiptare.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve:

- Nën patronatin e Presidentes së Republikës së Kosovës, është hapur ekspozita “E vërteta, kujtesa, drejtësia”, e realizuar me materiale arkivore të IKKL-së;
- Në ekspozitën “Tri ditë që ndryshuan historinë”, të organizuar nën patronatin e Kryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, IKKL ka kontribuar me materiale arkivore që dokumentojnë ngjarjet e marsit 1998 në Prekaz;
- Në bashkëpunim me Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Düsseldorf, Shoqatën e Studentëve Shqiptarë në Nordrhein-Westfalen dhe Këshillin e Studentëve të Universitetit Duisburg-Essen, IKKL ka organizuar ekspozitën “Helmimet në Kosovë (1990–1992)”, e mbajtur në

Düsseldorf më 11–16 maj, me qëllim të promovimit të kujtesës historike dhe sensibilizimit të opinionit publik ndërkombëtar mbi ngjarjet e helmimeve të nxënësve shqiptarë në Kosovë gjatë viteve 1990–1992.

## VEPRIMET BASHKËPUNUESE DHE MARRËVESHJET NDËRINSTITUCIONALE

Gjatë periudhës 8 nëntor 2025 – 8 maj 2026, IKKL ka vazhduar zgjerimin dhe konsolidimin e rrjetit të bashkëpunimeve ndërinstytucionale, me fokus në forcimin e partneriteteve akademike, shkencore dhe profesionale në nivel vendor dhe rajonal. Në këtë periudhë vihet re orientimi i Institutit drejt ndërtimit të kapaciteteve të qëndrueshme institucionale përmes bashkëpunimit me universitete, institucione shkencore, agjenci shtetërore dhe partnerë rajonalë që veprojnë në fushën e dokumentimit, hulumtimit dhe drejtësisë tranzicionale. Në këtë kuadër, janë iniciuar dhe formalizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë në Kosovë dhe rajon, përfshirë Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, Universitetin e Tetovës, Universitetin “Nëna Tereza” në Shkup, si dhe Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Këto partneritete synojnë zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore, edukative dhe profesionale, duke kontribuar në integrimin e dimensionit akademik dhe ndërdisiplinor në proceset e dokumentimit dhe analizës së krimeve të luftës. Njëkohësisht, bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) përfaqëson hap të rëndësishëm në fuqizimin e lidhjes së Institutit me komunitetin shkencor dhe akademik, duke krijuar mundësi për avancimin e hulumtimeve dhe ngritjen e cilësisë së prodhimit shkencor. Në të njëjtën linjë, marrëveshjet me Kolegjin Heimerer dhe institucionet universitare partnere kanë kontribuar në integrimin e ekspertizës profesionale në fushat e psikologjisë, trajtimit të traumës dhe qasjeve ndërdisiplinore në aktivitetet e Institutit. Në aspektin institucional dhe teknik, marrëveshja me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) përfaqëson zhvillim me rëndësi strategjike, pasi mundëson qasje në të dhëna zyrtare dhe kredibile, të domosdoshme për proceset e verifikimit dhe dokumentimit të viktimave të luftës. Ky bashkëpunim kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e saktësisë, besueshmërisë dhe standardizimit të të dhënave, duke forcuar më tej bazën faktike dhe institucionale të dokumentimit të krimeve të luftës në Kosovë (Tabela 6).

Në tërësi, marrëveshjet e realizuara gjatë kësaj periudhe reflektojnë zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimeve drejt konsolidimit të partneriteteve me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e punës së Institutit. Ky orientim strategjik kontribuon në rritjen e kapaciteteve kërkimore, përmirësimin e proceseve të verifikimit dhe integrimin e qasjeve ndërdisiplinore, duke e pozicionuar IKKL-në si një institucion gjithnjë e më të konsoliduar në fushën e dokumentimit, kujtesës historike dhe drejtësisë tranzicionale.

*Tabela 6. Bashkëpunimet institucionale sipas periudhave raportuese*

Periudha nëntor 2023 – nëntor 2024		Periudha nëntor 2024 – nëntor 2025		Periudha nëntor 2025 – maj 2026	
Emri	Statusi	Emri	Statusi	Emri	Statusi
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	E finalizuar	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë	E finalizuar	Universiteti i Tetovës-Fakulteti Filozofik, Tetovë	E finalizuar
American University in Kosovo –	E finalizuar	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të	E finalizuar	Universiteti Kadri Zeka, Gjilan(UKZ)	E finalizuar

Rochester Institute of Technology		Republikës së Shqipërisë			
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Maqedoni e Veriut	E finalizuar	Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë	E finalizuar	Universiteti Isa Boletini, Mitrovicë	E finalizuar
Agjencia e Statistikave të Kosovës	E finalizuar	Radio Televizioni i Kosovës (RTK)	Në proces	Universiteti Nëna Tereza në Shkup	E finalizuar
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	E finalizuar	Agjencia Kadastrave të Kosovës	E finalizuar	Kolegji Heimerer, Prishtinë	E finalizuar
Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	E finalizuar	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Muzeu Kombëtar i Kosovës, Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”	E finalizuar	Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT)	E finalizuar
Srebrenica Memorial Center	Në proces	Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve Pakicë në Mal të Zi	E finalizuar	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK)	E finalizuar
		Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	E finalizuar	Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC)	E finalizuar
		Radio Televizioni i Shqipërisë	Në proces	Agjencisë së punësimit të Republikës së Kosovës (APRK)	E finalizuar
		Unioni i Mediave të Shqipërisë	Në proces	Agjencisë së punësimit të Republikës (APRK) së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)	E finalizuar
				Unioni i Mediave, Tiranë	Në proces

				Federata Pan Shqiptare, VATRA	Në proces
				Universiteti Haxhi Zeka (UHZ) Pejë	Në proces
				Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" (UGJFA)	Në proces
				Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)	Në proces
TOTAL	7	10		15	
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>					
<b>32</b>					

## PJESËMARRJA NË FORUME DHE SEMINARE NDËRKOMBËTARE

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore, IKKL ka qenë pjesë aktive në forume, seminare dhe konferenca vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, përmes së cilave ka promovuar misionin institucional dhe ka ndërtuar ura bashkëpunimi me partnerë akademikë, diplomatikë dhe organizata ndërkombëtare që veprojnë në fushën e drejtësisë tranzicionale, dokumentimit dhe kujtesës historike. Këto angazhime kanë ndihmuar në forcimin e profilit ndërkombëtar të Institutit, në shkëmbimin e përvojave profesionale dhe në zgjerimin e rrjetit bashkëpunues për verifikimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Drejtori Ekzekutiv i IKKL-së mori pjesë në Forumin XVII për drejtësinë tranzicionale në vendet post-jugosllave: "E ardhmja përmes së kaluarës", i organizuar nga RECOM dhe Fondi për të Drejtën Humanitare (FHLC), i mbajtur më 13–14 dhjetor në Zagreb. IKKL ishte pjesë e vizitës studimore në Mbretërinë e Bashkuar me temën "Different Memories, Shared Futures: Towards Inclusive Memorialisation", organizuar nga British Council. Në këtë vizitë morën pjesë përfaqësues të organizatave, muzeve dhe institucioneve nga Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia, duke krijuar hapësirë të përbashkët për shkëmbim përvojash mbi praktikën e kujtesës dhe memorializimit të krimeve të luftës në Ballkanin Perëndimor. IKKL prezantoi në konferencën ndërkombëtare për memorializim në Rijeka të Kroacisë, të organizuar nga British Council, duke sjellë në fokus përvojën e Kosovës në dokumentimin e krimeve të luftës dhe ndërtimin e kujtesës kolektive. IKKL u përfaqësua në konferencën shkencore International Research Society for Public Management (IRSPM), e organizuar nga Edith Cowan University në Perth të Australisë. Kjo konferencë prestigjioze mbledhi mbi 360 studiues dhe akademikë nga mbarë bota. Në këtë ngjarje të rëndësishme, IKKL shpjegoi kontekstin e luftës në Kosovë, si dhe punën e saj hulumtuese, përmes një prezantimi të përbashkët me Prof. Catherine Althaus, Prof. Gerda van Dijk dhe znj. Mareli Colpi, duke theksuar rëndësinë thelbësore të dokumentimit të kujtesës kolektive për arritjen e paqes së qëndrueshme në rajonet e prekura nga luftërat. Në Sydney, përfaqësuesit e IKKL-së, të mbështetur edhe nga ish-zëvendësministri, z. Bardhyl Dobra, kontribuan gjithashtu në punëtorinë e organizuar nga Women's and Girls' Emergency Centre (WAGEC), duke ndarë ekspertizën e Kosovës në dokumentimin e krimeve të luftës, si dhe duke theksuar rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë. IKKL po ashtu mori pjesë si delegacion në shtetin e Izraelit në kuadër të trajnimeve të specializuara lidhur me dokumentimin e dhunës seskuale dhe dokumentimin e viktimave të luftës, duke përsosur qasjen e ndërtimit të narrativës për secilën viktimit të luftës. Ndër të tjera, IKKL mori pjesë edhe në vizita studimore në Qendrën Botërore për Dokumentimin e Holokaustit në Yad Vashem si dhe në Bibliotekën Kombëtare të Izraelit. Këto trajnime dhe vizita studimore u mundësuan nga Ambasada e Kosovës në Izrael.

## PRANIA MEDIATIKE DHE SENSIBILIZIMI PUBLIK

Gjatë periudhës raportuese, IKKL ka vijuar të forcojë identitetin institucional dhe praninë digjitale, duke përdorur rrjetet sociale dhe faqen zyrtare të internetit si kanale kryesore për komunikim publik dhe ndërveprim me komunitetin akademik dhe qytetar. Përveç zgjerimit të audiencës, është shënuar përmirësim i dukshëm në cilësinë e përmbajtjes, nivelin e interaktivitetit dhe transparencën institucionale, duke reflektuar një qasje më strategjike ndaj komunikimit publik.

Në kuadër të rritjes së pranisë publike dhe promovimit të aktiviteteve institucionale, Drejtori Ekzekutiv i IKKL-së ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm intervistash dhe emisionesh televizive në media vendore dhe rajonale, përfshirë emisione qendrore informative dhe debate të transmetuara në termine me shikueshmëri të lartë (prime time). Përmes këtyre paraqitjeve publike janë trajtuar tema që lidhen me dokumentimin e krimeve të luftës, drejtësinë tranzicionale, kujtesën historike dhe aktivitetet hulumtuese të Institutit, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe fuqizimin e prezencës institucionale në diskursin publik dhe akademik.

Në aspektin e performancës, gjatë periudhës raportuese faqja zyrtare në Facebook ka shënuar rritje të konsiderueshme në të gjithë indikatorët kryesorë. Numri i vizitave ka arritur në 66,000 (+108.1% krahasuar me periudhën paraprake), ndërsa klikimet në linke janë rritur në 944 (+427.4%). Po ashtu, ndërveprimet (pëlqime, komente dhe shpërndarje) kanë arritur në 22,000 (+153.4%), ndërsa shikimet e videove kanë shënuar rritje të jashtëzakonshme, duke arritur në 898,000, krahasuar me vetëm 5,208 në periudhën paraprake. Këto të dhëna tregojnë rritje të ndjeshme të angazhimit publik dhe efektivitetit të komunikimit digjital (Tabela 7).

*Tabela 7. Numri i ndjekësve në rrjetet sociale të IKKL-së (Facebook, Instagram, X dhe LinkedIn)*

Rrjeti social	nëntor 2023 - nëntor 2024	nëntor 2024 – nëntor 2025	8 nëntor 2025 - 8 maj 2026	Numri i ndjekësve
Facebook	3115	2255	1571	6941
Instagram	63	159	52	274
X (twitter)	70	32	47	149
LinkedIn	N/A	570	133	703
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>				<b>8067 +</b>

Rritja e performancës lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e përmbajtjeve me karakter edukativ dhe dokumentar, përfshirë ekspozitat, forumet “Za n’Kujtesë” dhe publikimet mbi aktivitetet kërkimore dhe bashkëpunimet ndërkombëtare të Institutit. Këto iniciativa kanë kontribuar në rritjen e vizibilitetit institucional dhe në forcimin e rolit të IKKL-së si burim i besueshëm informacioni mbi dokumentimin e krimeve të luftës.

Në nivel institucional, faqja zyrtare e internetit ([www.ikkl.rks-gov.net](http://www.ikkl.rks-gov.net)) mbetet platforma kryesore për transparencë, llogaridhënie dhe informim publik, duke ofruar qasje të hapur në raportet, dokumentet dhe publikimet e Institutit. Përmes këtij portali, IKKL siguron komunikim të vazhdueshëm me qytetarët, median dhe institucionet partnere.


## RAPORTI FINANCIAR

Gjatë periudhës raportuese, IKKL ka vazhduar të demonstrojë menaxhim efikas të burimeve financiare, duke siguruar realizim të lartë të buxhetit dhe mbulim të plotë të obligimeve financiare. Në vitin fiskal 2025, IKKL ka treguar performancë shumë të lartë financiare, me realizim të përgjithshëm të buxhetit prej 98.91%. Ky nivel i realizimit dëshmon kapacitet institucional për menaxhim efikas, transparent dhe të përgjegjshëm të resurseve publike. Në kategorinë Paga dhe mëditje, shpenzimet kanë arritur në 355,700.41 €, duke reflektuar rritje për shkak të harmonizimeve buxhetore dhe vendimeve të Qeverisë. Deficiti i krijuar është mbuluar plotësisht, pa lënë obligime të papaguara. Në kategorinë Mallra dhe shërbime, realizimi prej 99.77% dëshmon planifikim të saktë dhe disiplinë të lartë financiare.

Sa i përket vitit fiskal 2026, buxheti i aprovuar në vlerë prej 726,312.50 € paraqet rritje krahasuar me vitin paraprak, veçanërisht në kategorinë Mallra dhe Shërbime, duke reflektuar zgjerimin e aktiviteteve institucionale dhe nevojat operative të Institutit. Gjatë periudhës janar – prill 2026, shpenzimet e realizuara arrijnë në 224,413.29 €, ndërsa zotimet në 85,543.27 €. Në total, shpenzimet dhe zotimet arrijnë në 309,956.56 €, që përfaqëson rreth 42.67% të buxhetit të përgjithshëm të aprovuar, duke reflektuar fazën fillestare të ekzekutimit dhe angazhimit buxhetor për vitin fiskal 2026. Struktura e shpenzimeve vazhdon të dominohet nga kategoritë Paga dhe Mëditje si dhe Mallra dhe Shërbime, ndërsa në kategorinë Komunale nuk janë realizuar shpenzime gjatë kësaj periudhe raportuese.

Në tërësi, trendi financiar tregon stabilitet, kontroll të mirë buxhetor dhe menaxhim të qëndrueshëm financiar, me hapësirë të konsiderueshme për realizimin e aktiviteteve të planifikuara në pjesën e mbetur të vitit, në përputhje me planifikimet operative dhe prioritetet strategjike të Institutit.

Figura 1. Krahasimi i buxhetit sipas kategorive



## SFIDAT OPERATIVE

Gjatë kësaj periudhe, sfidat kryesore kanë qenë të ndërlidhura me pamundësitë për digjitalizimin e arkivit, zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore, fuqizimin e burimeve njerëzore dhe mbështetjen logjistike për aktivitetet në terren. Kufizimet në alokimin fillestar buxhetor dhe mungesa e mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale kanë ndikuar në shtyrjen e disa investimeve të planifikuara zhvillimore, përfshirë fillimin e zbatimit të projektit të digjitalizimit të materialeve arkivore. Megjithëse projekti është përgatitur dhe proceduar që në vitin 2024, mungesa e mbështetjes financiare ka pamundësuar funksionalizimin e tij gjatë kësaj periudhe.

Njëkohësisht, kufizimet hapësinore në zyrën qendrore vazhdojnë të paraqesin sfidë për organizimin efikas të punës, zgjerimin e arkivit fizik, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të bibliotekës institucionale. Rritja e vazhdueshme e fondit arkivor dhe dokumentar ka krijuar nevojë të domosdoshme për zgjerimin e hapësirave dhe përmirësimin e kushteve të ruajtjes dhe menaxhimit të materialeve arkivore.

Në aspektin e burimeve njerëzore, gjatë vitit 2025 nga Instituti janë larguar nëntë zyrtarë, kryesisht për shkak të natyrës së ndjeshme dhe emocionalisht të rënduar të punës, si dhe për shkak të kushteve më të favorshme në institucione të tjera. Megjithëse Instituti ka ndërmarrë hapa për konsolidimin e stafit dhe plotësimin e pozitave kyçe, vonesat procedurale në proceset e rekrutimit kanë ndikuar në mosplotësimin e një numri të konsiderueshëm të pozitave të parapara me strukturën organizative. Po ashtu, vazhdon të ekzistojë mospërputhje ndërmjet strukturës së miratuar organizative dhe kapaciteteve aktuale buxhetore, duke kufizuar funksionalizimin e plotë të strukturës së Institutit.

Sfidë shtesë mbetet edhe zhvillimi profesional i stafit, veçanërisht në fusha specifike që lidhen me verifikimin, arkivimin, analizën e të dhënave dhe trajtimin e materialeve sensitive. Natyra specifike e mandatit të Institutit kërkon ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve profesionale, metodologjike dhe teknike të stafit, si dhe mbështetje të vazhdueshme profesionale në përballimin e ngarkesës emocionale që lidhet me trajtimin e materialeve dhe dëshmimeve të luftës.

Në aspektin logjistik, edhe pse zyrat rajonale kanë pasur në dispozicion dy automjete të përdorura me rotacion, kapacitetet aktuale të transportit vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme për realizimin optimal të aktiviteteve në terren dhe procesit të mbledhjes së materialeve dokumentare në të gjitha rajonet e Kosovës. Kjo ka ndikuar në kufizimin e lëvizshmërisë së stafit dhe në ritmin e realizimit të aktiviteteve dokumentuese dhe verifikuese në terren.

Pavarësisht këtyre sfidave, gjatë periudhës raportuese IKKL ka vazhduar të avancojë proceset e brendshme organizative, të forcojë mekanizmat institucionalë të menaxhimit dhe të zhvillojë kapacitete të qëndrueshme në funksion të dokumentimit të besueshëm të krimeve të luftës, ruajtjes së kujtesës historike dhe avancimit të proceseve të drejtësisë tranzicionale në Republikën e Kosovës.

## PRIORITETET STRATEGJIKE PËR PERIUDHËN PASUESE (2026)

Gjatë periudhës së ardhshme, Instituti do të vazhdojë të fokusohet në forcimin e kapaciteteve institucionale, avancimin e proceseve të dokumentimit dhe hulumtimit shkencor, si dhe zgjerimin e bashkëpunimeve vendore dhe ndërkombëtare në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe kujtesës historike. Prioritet qendror për vitin 2026 mbetet përmbyllja dhe publikimi i Databazës së Viktimave të luftës në Kosovë për periudhën 1998–2000, paralelisht me zhvillimin e databazës për masakrat dhe varrezat masive në Kosovë. Tanimë është arritur progres i rëndësishëm në avancimin e Databazës së Viktimave drejt fazës finale të verifikimit dhe harmonizimit të të dhënave. Procesi aktual është fokusuar në krahasimin ndërburimor të informatave, verifikimet shtesë në terren dhe integrimin e të dhënave relevante nga fondet arkivore dhe institucionale, me qëllim garantimin e nivelit më të lartë të saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit. Publikimi i kësaj databaze gjatë vitit 2026 pritet të shënoj zhvillim me rëndësi të veçantë institucionale dhe shoqërore, duke krijuar kështu për herë të parë një pasqyrë të plotë dhe të verifikuar mbi humbjet njerëzore të luftës në Kosovë, si dhe duke kontribuar në forcimin e kujtesës kolektive dhe proceseve të drejtësisë tranzicionale në vend.

Një ndër prioritetet kryesore mbetet edhe funksionalizimi i projektit të digjitalizimit të arkivit të IKKL-së, i përgatitur gjatë vitit 2024. Ky projekt synon modernizimin e sistemit të menaxhimit arkivor, rritjen e sigurisë së ruajtjes afatgjatë të materialeve dhe krijimin e një sistemi të integruar elektronik për administrimin dhe kërkimin e të dhënave. Në këtë drejtim, Instituti do të vazhdojë angazhimet për sigurimin e mbështetjes teknike dhe financiare në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet relevante shtetërore.

Në fushën e komunikimit publik dhe promovimit të kujtesës historike, gjatë vitit 2026 planifikohet organizimi i ekspozitave dhe aktiviteteve kulturore në Kosovë dhe në diasporë, me fokus në bashkëpunimin me institucionet akademike dhe komunitetet e mërgatës shqiptare. Po ashtu, Instituti planifikon publikimin e katalogëve dhe vëllimeve shkencore ndërkombëtare, me qëllim të avancimit të aktivitetit botues dhe promovimit të dokumentimit shkencor të luftës në Kosovë.

Në aspektin organizativ dhe profesional, prioritet do t'i jepet ngritjes së mëtejshme të kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve të specializuara në fushat e verifikimit, arkivimit, analizës së të dhënave dhe menaxhimit të dokumentacionit sensitiv, si dhe përmirësimit të infrastrukturës teknologjike dhe logjistike të Institutit.

Përmes realizimit të këtyre prioritetëve, IKKL synon të avancojë më tej rolin si institucion qendror shtetëror për dokumentimin e krimeve të luftës, ruajtjen e kujtesës historike dhe zhvillimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale në Republikën e Kosovës.

Përmes aktiviteteve të realizuara gjatë kësaj periudhe, IKKL ka konsoliduar themelet institucionale për zhvillimin e sistemit shtetëror të dokumentimit, kujtesës historike dhe drejtësisë tranzicionale në Republikën e Kosovës.

## KËRKESAT KRYESORE PËR PERIUdhËN PASUESE

### NEVOJA PËR RITJE TË BUXHETIT – PROJEKTI I DIGJITALIZIMIT

Analiza e realizimit buxhetor për vitin 2025 ka dëshmuar se kapacitetet aktuale financiare mbeten të pamjaftueshme për mbulimin e plotë të nevojave zhvillimore dhe realizimin e prioriteteve strategjike të Institutit. Në këtë drejtim, prioritet kryesor për periudhën e ardhshme mbetet fillimi i zbatimit të projektit të digjitalizimit të materialeve arkivore dhe dokumenteve institucionale, i cili paraqet një nga projektet më të rëndësishme zhvillimore të IKKL-së. Për vitin 2026, IKKL ka propozuar planifikim buxhetor në vlerë prej 1,642,422.15 €, nga të cilat 550,000.00 € janë paraparë për fazën fillestare të projektit të digjitalizimit. Projekti synon skanimin dhe arkivimin digjital të materialeve fizike, krijimin e një sistemi të integruar për menaxhimin dhe kërkimin e të dhënave, si dhe ngritjen e infrastrukturës teknologjike për ruajtjen afatgjatë dhe të sigurt të dokumentacionit. Megjithëse dokumentacioni teknik dhe metodologjik për realizimin e projektit është përgatitur, mungesa e mbështetjes financiare ka penguar fillimin e zbatimit praktik të tij. Për këtë arsye, sigurimi i mbështetjes buxhetore për digjitalizimin mbetet i domosdoshëm për modernizimin e sistemit arkivor, rritjen e efikasitetit institucional dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 08/L-177.

### NEVOJA PËR ZGJERIM HAPËSINOR

Mungesa e hapësirës së mjaftueshme në zyrën qendrore të Institutit vazhdon të paraqesë një nga sfidat kryesore operative dhe organizative. Rritja e vazhdueshme e fondit arkivor, zhvillimi i bibliotekës institucionale dhe zgjerimi i aktiviteteve dokumentuese kanë krijuar nevojë të domosdoshme për përmirësimin dhe zgjerimin e kapaciteteve hapësinore. Në këtë kuadër, është propozuar zhvendosja e zyrave qendrore në hapësirat e lira të objektit ku aktualisht ndodhet Agjencia Kadastrale e Kosovës. Ky veprim do të krijonte kushte më të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve administrative, hulumtuese dhe profesionale të Institutit, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e kushteve të punës për stafin. Njëkohësisht, mbetet prioritar adresimi i nevojës për hapësira adekuate për arkivin fizik dhe bibliotekën e Institutit, me qëllim garantimin e ruajtjes afatgjatë, sistemimit profesional dhe mbrojtjes së materialeve dokumentare dhe bibliotekare.

### NEVOJA PËR PËRMIRËSIM TË LOGJISTIKËS DHE TRANSPORTIT

Gjatë periudhës raportuese është evidentuar nevoja për fuqizimin e kapaciteteve logjistike dhe të transportit, të cilat mbeten element kyç për realizimin efektiv të aktiviteteve në terren dhe procesit të mbledhjes së materialeve dokumentare. Kapacitetet aktuale të transportit, të përdorura me rotacion ndërmjet zyrave rajonale, kanë mundur vetëm mbulim të pjesshëm të nevojave operative të Institutit. Si rezultat, lëvizshmëria e stafit dhe dinamika e aktiviteteve në terren vazhdojnë të mbeten të kufizuara, duke ndikuar në efikasitetin e proceseve të dokumentimit dhe verifikimit. Për këtë arsye, sigurimi i mjeteve të dedikuara të transportit për zyrat rajonale, si dhe avancimi i kapaciteteve logjistike, mbetet prioritet i rëndësishëm për periudhën në vijim, me qëllim rritjen e efikasitetit operacional dhe përmbushjen më të avancuar të mandatit institucional të IKKL-së.



info.ikkl@rks-gov.net

+383 38 200 14 359

Rr. Arbënor e Astrit Dehari, Nr. 25, Prishtina 10000, Republika e Kosovës

Facebook: <https://www.facebook.com/ikkl.rks>

Instagram: @ikkl\_rks

X/Twitter: @ikkl\_rk

